



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

Datë: 12.06.2025

Numër Protokolli: 4223/2025

A.nr.520/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Rushit Kajtazi si procesmbajtës, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.520/2025, të datës 21.03.2025, të parashtruar nga ankuesi, D.N, kundër organit të punësimit: Ministria e Punëve të Brendshme-Departamenti për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3, si dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 12.06.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.520/2025, e datës 21.03.2025, e parashtruar nga ankuesi, D.N.

I. Mbetet në fuqi akti përfundimtar i datës 28.02.2025, i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, të Ministrisë së Punëve të Brendshme, lidhur shpalljen e kandidatëve fitues për procedurën e pranimit me numër të referencës RN00016093 Grupi i Burimeve Njerëzore, pozita Zyrtar i Lartë për Zhvillimin e Rekrutimit në Nivelin e Lartë Drejtues.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbim civil D.N (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi*), më datë 21.03.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference RN00016093, për Grupin e Burimeve Njerëzore, pozitë e punës Zyrtar i Lartë për Zhvillimin e Rekrutimit në Nivelin e Lartë Drejtues, Ministria e Punëve të Brendshme.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 11.04.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Brendshme-Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, ndërsa, kjo e fundit, më datë 18.04.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë.

Tutje, Kryetari i Këshillit, me vendim me numër protokollit 2934/2025, të datës 02.05.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr. 520/2025, të parashtruar nga ankuesit edhe për dhjetë (10) ditë pune, lidhur me ankesën e ankuesi D.N.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas konstatimit së ankesa është e pranueshme në kuptim të nenit 129 të LPPA-së, administroi këto prova: Ankesën më numër protokollit 1870/2025 të datës 21.03.2025 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin e datës 28.02.2025, i nxjerr nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore i Ministrisë së Punëve të Brendshme; Konkursin me numër reference RN00016093 të datës 09.01.2025; Kopjen e Letërnjoftimit të ankuesit; Akt Emërimi me numër protokollit AE.nr.01-110-101-03-55600, i datës 29.10.2021, për D.N; Autorizim i datës 08.08.2022; Vërtetim mbi përvojën e punës i datës 04.11.2024; Vërtetim i datës 18.12.2024; Vërtetim i datës 25.11.2017; Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 07.11.2009; Certifikatë e datës 18.05.2023, për D.N; Certifikatë e datës 11-12, e muajit nëntor e vitit 2021, për D.N; Certifikatë e datës 08-09, e muajit nëntor e vitit 2021, për D.N; Njoftimi me numër protokollit 241, i datës 11.02.2025, i nxjerr nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore i Ministrisë së Punëve të Brendshme; Emali i datës 20.02.2025, dërguar nga SIMBNJ, për D.N; Njoftimi me numër protokollit 310, i datës 21.02.2025, i nxjerr nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore i Ministrisë së Punëve të Brendshme; Diplomë me numër protokollit 1385, e datës 20.04.2017, për D.N, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"; Diplomë me numër protokollit 517 e datës 30.03.2009, për D.N, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës; Diplomë me numër protokollit 1382, e datës 25.10.2019, për D.N, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"; Diplomë me numër protokollit 1365, e datës 26.08.2010, për D.N, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 11.04.2025, dërguar nga Y.F, për A.G; Përgjigjen në ankesë me numër protokollit 520/2025, e datës 18.04.2025; Kopje e letërnjoftimit për V.P.B; Vërtetim i datës 17.01.2025, i nxjerr nga Sektori i Burimeve Njerëzore i Komunës së Klinës; Pasqyra e trustit për periudhën nga data 01.08.2002, deri me datën 14.01.2025, për V.P.B; Aplikacioni i Xh.K, me shkresat e bashkangjitura; Diplomë me numër protokollit 6452, e datës 12.09.2019, për Xh.K, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"; Diplomë me numër protokollit 2875, e datës 24.01.2023, për Xh.K, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"; Certifikatën e datës 10.06.2021, për Xh.K; Vërtetimi i marrëdhënies së punës i datës 03.02.2025; Certifikatë për Xh.K; Kopje e letërnjoftimit për Xh.K; Pasqyra e trustit për periudhën nga data 25.01.2024, deri me datën 24.01.2025, për Xh.K; Vërtetim i datës 30.08.2023, për V.P; Kontrata e punës e datës 08.07.2024, për V.P.B; Formuari për vlerësimin e rezultateve në punë për D.N; Vërtetim me numër protokollit 01-+116-01-59778 i datës 18.12.2024; Aplikacioni i V.P.B, me shkresat e bashkangjitura; Diplomë me numër protokollit 1640, e datës 04.02.2004; Diplomë me numër protokollit 1018, e datës 29.10.2018, për V.P.B, e lëshuar nga Kolegji Fama; certifikatë për V.P.B; certifikatë e datës 16.01.2023 për V.P.B; Vërtetim me numër protokollit 14-113-02-110557/23, i datës 06.06.2023; Vërtetim i datës 25.11.2017, për D.N; Vendimin me Nr.227/2025 të datës 12.02.2025, për Themelimin e Komisionit të Pranimit, i nxjerr nga Sekretarja e Përgjithshëm e MPB-së; Renditja përfundimtare e kandidatëve; Aplikacioni i D.N, me shkresat e bashkangjitura; Diplomë me numër protokollit 1385, e datës 20.04.2017, për D.N, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"; Diplomë me numër protokollit 517 e datës 30.03.2009, për D.N, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës; Diplomë me numër protokollit 1382, e datës 25.10.2019, për D.N, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"; Diplomë me numër protokollit 1365, e datës 26.08.2010, për D.N, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës; Certifikatë e datës 08-09, e muajit nëntor të vitit 2021; Certifikatë e datës 11-12, e muajit nëntor të vitit 2021; Njoftimi i datës 11.02.2025; Përshkrimi i detyrave të punës Zyrtar i Lartë për Zhvillimin e Rekrutimit në Nivelin e Lartë Drejtues; Listën e aplikantëve; Emali i datës 27.12.2024, dërguar nga Q.B, për A,G; Emali i datës 24.02.2024, dërguar nga B.C, për D.N; Testi me shkrim;

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është e pabazuar, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton:

- Ministria e Punëve të Brendshme, më datë 09.01.2025, ka shpallë konkursin me numër reference RN00016093, për Grupin e Burimeve Njerëzore, gjegjësisht për pozitën e punës Zyrtar i Lartë për Zhvillimin e Rekrutimit në Nivelin e Lartë Drejtues, në Departamentin e Menaxhimit të Zyrtarëve Publik, me klasë të pozitës Profesional 1, për dy (2) vende të lira pune, të hapur për aplikim 10.01.2025 deri 08.02.2025.

- Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë (83) kandidatë, përfshirë edhe ankuesin, ndërsa, i njëjti i është nënshtruar edhe fazës së vlerësimit profesional, ashtu që, i njëjti në testin me shkrim ka arrit të grumbulloj 60.8 pikë, ndërsa, në intervistën më gojë, ka arrit 19.8 pikë, gjithsej 80.6 pikë.

- Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, më datë 28.02.2025, ka publikuar Njoftimin për rezultatin përfundimtar të kandidatëve fitues, nga i cili njoftim rezulton se si kandidatë më shumë pikë të arritura për pozitën përkatëse janë shpallur: Xh.K me gjithsejtë 91.6 pikë dhe V.P-B me 87.4 pikë.

Pas publikimit të rezultatit përfundimtar të kandidatëve të datës 28.02.2025, ankuesi brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të shkeljes së dispozitave procedurale administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe shkeljes së ligjit material. Shton së Komisioni i Pranimit i është shmangur parimit të meritës, paanësisë, jo diskriminimit dhe profesionalizmit, ashtu që sipas ankuesi ka bërë nënvlerësim të tij si në testin më shkrim ashtu edhe në intervistën më gojë. Kërkon nga Këshilli që të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anuloj procedurën e rekrutimit me numër reference RN00016093 në tërësi.

Kolegji i Këshilli mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *“Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes”*, ka analizuar në kuptim të ligjshmërisë veprimet administrative të ndërmarra në procedurën e rekrutimit RN00016093. Andaj, në kontest të këtij përcaktimi, Kolegji fillimisht sipas shqyrtimit të aktit të shpalljes së konkursit ka gjetur se si kërkesa të përgjithshme formale në procedurën përkatëse të rekrutimit janë vendosur: **Arsimimi i kërkuar:** *Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor). Juridik, Ekonomi, Psikologji, Administratë Publike, Pedagogji, Menaxhim i Burimeve Njerëzore;* **Përvoja e punës e kërkuar:** *Së paku 2 (dy) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës, dhe si rrjedhojë Kolegji vlerësoj së kriteret e përgjithshme për pozitën përkatëse të punës janë në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.*

Ndërsa, nga analizimi i Vendimit Nr.227/2025, të datës 12.02.2025, të Sekretares së Përgjithshme të MPB-së, lidhur me themelimin e Komisionit ad hoc për vlerësimin profesional të kandidatëve në procedurën e pranimit më numër të referencës RN00116093, rezulton së përbërja e Komisionit të Pranimit, ka qenë në pajtim më kërkesat ligjore të përcaktuara më nenin 40 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku parshihet: *Vlerësimi profesional i kandidateve/ëve për pranimit në shërbim civil në pozitë të kategorisë profesionale bëhet nga komisioni i pranimit. 2. Komisioni i*

pranimi ka pesë (5) anëtare/ë, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunës/ës civil të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues të specializuar në fushën përkatëse sipas grupit për të cilin zhvillohet konkurrimi; 2.2. një (1) përfaqësues/ës nga njësia përgjegjëse; dhe 2.3. një (1) nëpunës/ës i kategorisë profesionale të fushës përkatëse për kategorinë profesionale.

Ndërsa, në kuptim të bazueshmerisë së pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrarët Publikë, me theks të veçantë:

Nenit 9: *1. Kriteret e përgjithshme që një person duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë: 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik; 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 1.8. të kaloj me sukses procedurat e pranimi të përcaktuara në këtë ligj. 2. Përfundimisht, për pozita specifike të zyrtares/it publik, mund të kërkojnë kritere specifike shtesë. Procedura dhe kriteret për plotësimin e përshtatshmërisë dhe/apo të kriterëve specifike shtesë, do të përcaktohet me akt nënligjor të miratuar nga Qeveria, me propozim të ministrisë përgjegjëse për administratë publike.*

Nenit 39: *1. Pranimi në shërbimin civil bëhet në të gjitha kategoritë e shërbimit civil, nëpërmjet një procedure rekrutuese të hapur dhe publike, përveç kur parashikohet ndryshe me këtë ligj. 2. Rekrutimi për kategorinë profesionale organizohet për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe pozitë apo grup pozitash të administrimit të veçantë, sipas nevojës së institucionit dhe sipas planifikimit të NjMBNj-së", 2. Rekrutimi për kategorinë profesionale organizohet për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe pozitë apo grup pozitash të administrimit të veçantë, sipas nevojës së institucionit dhe sipas planifikimit të NjMBNj-së. 3. Rekrutimi për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe të veçantë organizohet nga njësia përgjegjëse. 4. Përfundimisht përcaktimeve të këtij ligji, për institucionet që kanë nëpunës/e civil me status të veçantë, procedurat e rekrutimit i zhvillon NjMBNj e atij institucioni. 5. Shpallja e procedurës së rekrutimit për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe të veçantë, bëhet nga njësia përgjegjëse në SIMBNj-së, si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit. 6. Pranimi i aplikacioneve bëhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e shpalljes së procedurës së rekrutimit. 7. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 8. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional i kandidatëve bëhet nga komisioni i pranimi i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë, për të cilin zhvillohet rekrutimi...."*

Po ashtu, Kolegji i Këshillit për vendosje të drejtë dhe meritore mori parasysh edhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me konkret:

- **Nenin 7:** *Verifikimi paraprak 1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidatët për pranim në shërbimin civil plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit. 2. Verifikimi paraprak kryhet nga NjMBNj, më së largu pesëmbëdhjetë (15) ditë pas kalimit të afatit për pranimin e aplikacioneve, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit. 3. NjMBNj publikon në SIMBNj dhe uebfaqen e institucionit listën e kandidatëve të cilët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato specifike. 4. NjMBNj njofton kandidatët që nuk plotësojnë kushtet për rekrutim, duke përfshirë të gjitha kriteret dhe/ose dëshmitë e pa përmbushura jo më vonë se tre (3) ditë kalendarike nga data e publikimit të rezultateve.*

-Nenin 8: *Vlerësimi profesional Faza e vlerësimit profesional përbëhet nga testi me shkrim dhe intervista dhe zhvillohet nga Komisioni i Pranimit me mbështetjen e NjMBNj.*

-Neni 9: *Vlerësimi nëpërmjet testimit me shkrim 1. Vlerësimi nëpërmjet testimit me shkrim është hapi i parë i procesit të vlerësimit profesional të kandidatëve pas verifikimit paraprak, dhe duhet të realizohet më së largu 15 ditë pas publikimit të listës së kandidatëve që kanë kaluar verifikimin paraprak. 2. Në testimin me shkrim, kandidatët vlerësohen për njohuritë, aftësitë dhe cilësitë kryesore të domosdoshme, të kërkuara për pozitën apo grupin e pozitës përkatëse. 3. Vlerësimi maksimal i mundshëm për testimin me shkrim është deri në shtatëdhjetë (70) pikë. 4. Testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim. 5. Komisioni i Pranimit në përbërje të plotë është i obliguar ditën e zhvillimit të testimit me shkrim të përzgjedhë nga bankat e pyetjeve që disponon Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, pyetjet e testit me shkrim të modelit zgjedhje e shumëfishtë me një përgjigje të saktë, si dhe një ese me shkrim, duke marrë parasysh fushat e njohurive dhe aftësive të përcaktuara në shpalljen për rekrutim. 6. Testi me shkrim përmban gjithsej njëzet e pesë (25) pyetje dhe një (1) ese të shkurtër. Secila përgjigje e saktë vlerësohet me dy (2) pikë, ndërsa eseja mund të vlerësohet me më së shumti njëzetë (20) pikë. 7. Kohëzgjatja e testimit me shkrim është jo më shumë se nëntëdhjetë (90) minuta. 8. Anëtarët e Komisionit të Pranimit, vlerësojnë testin me shkrim në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, më së voni në afat prej dhjetë (10) ditësh nga dita e përfundimit të tij. Pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë vlerësohen nga sistemi në mënyrë elektronike, ndërsa eseja vlerësohet nga Komisioni i Pranimit. 9. Eseja vlerësohet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Pranimit në mënyrë individuale, të cilët e nënshkruajnë formularin e vlerësimit dhe vendosin pikët në SIMBNJ. Mbledhja e pikëve të secilit anëtar të Komisionit, nxjerr mesataren e vlerësimit përfundimtar për ese nga ana e Komisionit, për një kandidat të caktuar. Shuma e pikëve të vlerësuara nga sistemi dhe pikëve të esesë, përbën vlerësimin përfundimtar të testimit me shkrim. 10. Pas vlerësimit të testimit me shkrim, NjMBNj sipas rekomandimeve të Komisionit të Pranimit e përpilon listën e kandidatëve që e kanë kaluar testimin me shkrim. 11. Lista sipas paragrafit 10 të këtij neni bëhet publike nga NjMBNj në SIMBNJ, faqen e institucionit si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit.*

-Nenin 10: *Vlerësimi nëpërmjet intervistës 1. Pas vlerësimit të testimit me shkrim, vlerësimi i kandidatëve vazhdon me intervistën, e cila realizohet në mënyrë verbale e cila duhet të përfundojë më së voni pesëmbëdhjete (15) ditë pas publikimit të listës së kandidatëve që kanë kaluar testimin me shkrim. 2. Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim, kanë të drejtë të marrin pjesë në intervistë. 3. Komisioni i Pranimit njofton kandidatët që kanë kaluar me sukses testimin me shkrim lidhur me ditën, kohën dhe vendin e mbajtjes së intervistës. 4. Në intervistë, vlerësohen njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara që nuk mund të vlerësohen nëpërmjet testimit me shkrim. 5. Intervista zhvillohet nga Komisioni i Pranimit i cili përgatit apo përzgjedh nga bankat e pyetjeve grup pyetjesh të njëjta për të gjithë kandidatët për intervistën. Këto pyetje duhet të përgatiten/përzgjedhin në ditën e zhvillimit të intervistës, përveç pyetjes për prezantim nga paragrafi 7 i këtij neni që përzgjidhet dhe u dërgohet kandidatëve së bashku me njoftimin për orarin e intervistës. 6. Intervista në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, përmban pesë (5) pyetje, ku secila vlerësohet me më së shumti katër (4) pikë. Përveç pyetjeve, anëtarët e Komisionit të Pranimit mund të parashtrojnë edhe nën pyetje për kandidatin me qëllim të vlerësimit më të saktë të kandidatit lidhur me pyetjen kryesore. 7. Intervista për kandidatët për pozitën e kategorisë së lartë drejtuese bazohet në kompetencë dhe përmban pesë (5) pyetje të cilat vlerësohen me më së shumti tre (3) pikë, si dhe një (1) pyetje për prezantim e cila vlerësohet me më së shumti 5 pikë. 8. Secili nga anëtarët e Komisionit të Pranimit bën vlerësimin e detajuar për secilën pyetje. 9. Në intervistë kandidati mund të merr më së shumti tridhjetë (30) pikë, ku prej tyre dhjetë (10) pikë janë për jetëshkrimin (CV). 10. Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin ndahet si vijon: 10.1. deri në tre (3) pikë për arsimimin; 10.2. deri në katër (4) pikë për përvojën relevante në punë; dhe 10.3. deri në tre (3) pikë për trajnimet relevante. 11. Vlerësimi përfundimtar i intervistës për një kandidat është mesatarja aritmetike e vlerësimeve e të gjithë anëtarëve.*

-Nenin 11: *Shpallja e rezultatit përfundimtar 1. Vlerësimi përfundimtar i kandidatit përfshin shumën e pikëve të përfituara në secilin hap të vlerësimit. 2. Pas përfundimit të intervistës, Komisioni i Pranimit përgatit listën përfundimtare të kandidatëve që kanë kaluar pragun prej 70% të pikëve totale që e përcjell te NjMBNj, emrin dhe mbiemri e kandidatit fitues, si dhe pikët e arritura në testin me shkrim, intervistën dhe pikët e përgjithshme për secilin kandidat.*

Si rrjedhojë, bazuar në kuadrin përkatës ligjor, si dhe duke u bazuar në analizimin e provave materiale të parashtuara nga palët në procedurë, Kolegji ka gjetur se pretendimet ankimore të ankuesit nuk janë të bazuar dhe te argumentuar, mbi arsytet se Kolegji ka konstatuar se vlerësimi i kandidatëve lidhur me procedurën përkatëse të rekrutimit është realizuar në mënyrë elektronike, pyetjet e testit kanë qenë të njëjta për të gjithë kandidatet, dhe të përgatitura në pajtim me kërkesat ligjore të përcaktuara me nenin 9 paragrafi 5 dhe 6 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, gjegjësisht testi ka përmbajtur 25 pyetje më përgjigje të shumëfishta dhe një pyetje në formë të eses. Rrjedhimisht, duke u bazuar në shqyrtimin e testit të aplikuar në procedurën e kontestuar, Kolegji nuk vëren te meta në vlerësimin e drejtë të ankuesit lidhur me testin me shkrim, pasi që ankuesi ka dhënë 21 përgjigje të sakta duke arritur 42 pikë, vlerësim ky që behët përmes sistemit elektronik, ndërsa, në vlerësimin e esesë ankuesi është vlerësuar me 18.8 pikë, nga 20 pikë maksimale, duke arritur gjithsej 60.8 pikë, si pikë të mjaftueshme për të vazhduar me fazën tjetër të vlerësimit gjegjëshit intervistën më gojë, e në të cilën fazë ankuesi është vlerësuar nga anëtarët e Komisionit të Pranimit me 19.8 pikë, duke grumbulluar në total 80.6 pikë, dhe njëkohësisht duke u renditur si kandidati i tretë më shumë pikë të vlerësimit. Andaj, mbi gjendjen e këtyre fakteve Kolegji nuk ka gjetur trajtim jo profesional, jo të barabartë apo diskriminues të ankuesit në raport me kandidatët tjerë.

Po ashtu, Kolegji në vështrim të parimit të meritokracisë, si një nga parimet bazë për pranim në shërbim civil, dhe një nga pretendimet e ankuesit, ka analizuar dosjen e aplikimit të kandidateve fituese (dokumentacionin e dorëzuar së bashku me përgjigjen në ankesë), duke konstatuar këtë gjendje faktike:

-Kandidatja Xh.K posedon: Diplomën me numër Nr.6452, të datës 12.09.2019, për përfundimin e studimeve themelore më datë 02.08.2019, në Fakultetin Juridik, Universiteti i Prishtinës Hasan Prishtina, duke marrë titullin Jurist i Diplomuar–Baçelor, Diplomën me numër Nr.2875 të datës 24.01.2023, për përfundimin e studimeve master në LL.M Master në të drejtën Penale, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”. Përkitazi me kriterin formal lidhur në përvojën e punës profesionale pas diplomimit, kandidatja ka ofruar si dëshmi: Certifikatën e datës 10.06.2025, të lëshuar nga Kryetari i Gjykatës Themelore në Mitrovicë me të cilat akte vërtetohet se e njëjta ka kryer praktiken gjyqësorë nga data 08.06.2020, deri me datën 08.06.2021, si dhe sipas vërtetimit të lëshuar nga FST, Enigineering SH.P.K, nga data 01.11.2022, deri me datën 01.11.2023, në pozitën “Asistente Administrative”, kandidatja ka bashkangjitur Pasqyrën e Trustit Pensional ku vërtetohet gjendje e njëjtë më atë të konstatuar më aktet e sipër theksuar.

-Kandidatja V.P-B posedon: Diplomën me numër Nr.610/1018 të datës 29.10.2018, për përfundimin e studimeve themelore më datë 19.10.2018, në Kolegjin Fama, duke marrë titullin Baçelor i Arteve në Shkenca Politike dhe Administratë Publike, ndërsa përkitazi me përvojën e punës e njëjta ka bashkangjitur Vërtetimin për marrëdhënien e punës, me numër protokollit 14-113/01-177048/23, të datës 30.08.2023, të lëshuar U Sektorin i Burimeve Njerëzore të Komunitetit të Prishtinës, më të cilën vërtetohet se e njëjta nga data 26.04.2022 është e angazhuar në pozitën Bashkëpunëtorë në sektorin e gjendjes civile në kuadër të Drejtorisë së Administratës të Komunitetit të Prishtinës, si dhe Vërtetimin për marrëdhënien e punës të datës 17.01.2025, të lëshuar Sektorin i Burimeve Njerëzore të Komunitetit të Prishtinës, më të cilën vërtetohet se e njëjta është e angazhuar me kontratë pune me kohe të caktuar nga data 08.07.2024 deri me 07.07.2027 në pozitën Zyrtare mbështetëse në Sektorin

e Gjendjes Civile në kuadër të Drejtorisë së Administratës të Komunës së Prishtinës, përvojë kjo e dëshmuar edhe më Pasqyrën e Trustit Pensionale (të datës 16.01.2025).

Andaj, si pasojë e analizimit të dokumentacionit të aplikimit të kandidateve fitues, rrjedhë së të njëjtit kanë plotësuar kriteret e përgjithshme formale të përcaktuar me konkursin e kontestuar, e duke qenë se të njëjtit kanë arritur numrin më të madh të pikëve, atëherë, më të drejt njësia përgjegjëse, në këtë rast Divizioni i Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, i ka shpallur si kandidatë fitues për procedurën me numër reference RN00016093,e në pajtim më nenin 11 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Bazuar në konstatimet si me lartë, dhe duke qenë së nuk janë evidentuar shkeljeje ligjore në procedurën e kontestuar atëherë Kolegji i Këshillit erdhi në përfundimin së procedura me numër reference RN00016093, është zhvilluar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrarët Publikë, si dhe Rregulloren Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, kështu që në kuptim të dispozitave të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenit 132, paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS **Lënda me numër A.nr.520/2025**

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Malsore GASHI – BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, D.N;
- Njësisë se Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.